



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300453/2

Tiranë ___/___/2023

Lënda: *Rekomandime për inspektimin e kryer në ambientet e shoqërimit në Komisariatin e Policisë Librazhd.*

Drejtuar: **Z. Sali SKURA**
Shef i Komisariatit të Policisë Librazhd

LIBRAZHD

Për dijëni: **Z. Ilir PRODA**
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

ELBASAN

I nderuar Z. Skura,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga inspektimi i kryer në ambientet e privimit të lirisë së personit në Komisariatin e Policisë Librazhd nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Komisariatin e Policisë Librazhd në datën 17.05.2023, sipas një Plani Inspektimi vjetor të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita dhe znj. Lindita Dedgjoni me detyrë Nd/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar; Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, "Për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre" dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit".

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrijë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës u takua me shefin e komisariatit z. Sali Skura, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Qëllimi i inspektimit të MKPT-së ishte monitorimi i respektimit të situatës së të drejtave dhe lirive të njeriut, të personave të shoqëruar, të ndaluar dhe të arrestuar në flagrancë, duke përfshirë këtu kushtet infrastrukturore, respektimin e të drejtave dhe garancive procedurale të tyre të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin “Për Policinë e Shtetit”, ofrimin e shërbimit shëndetësor, verifikimin e rasteve të pretenduara për ushtrim dhune, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm.

Pasi u njoh me qëllimin e inspektimit, shefi i komisariatit informoi grupin e inspektimit në lidhje me kushtet në të cilat ndodhet ambienti i shoqërimit, angazhimin e punonjësve të policisë së këtij komisariati për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të personave të privuar nga liria në këto ambiente.

Grupi i inspektimit, shoqëruar nga shefi i komisariatit, vijoi inspektimin në ambientet e shoqërimit të komisariatit, vizitoi zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar.

Theksojmë se, drejtuesit dhe punonjësit e policisë së Komisarariatit të Policisë Librazhd me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues gjatë komunikimit dhe inspektimit që u zhvillua në ambientet e këtij institucioni.

Në Komisariatin e Policisë Librazhd, nga informacioni i grumbulluar gjatë kryerjes së inspektimit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2022¹, rezultoi se:

1. **Nuk është zbatuar rekomandimi**, për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Librazhd, sipas kritereve të parashikuara në Kreun VII, pika 4 të procedurave standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për ndërtimin e ambienteve të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrimin në dhomat e shoqërimit të ndara më vete për persona të rritur, femra dhe të mitur në konflikt me ligjin dhe mos ndërtimin e komisariateve që nuk janë në përputhje me “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”.

¹ Dërguar rekomandimi “Për ambientet e shoqërimit në Komisariatin e Policisë Librazhd”.

2. **Nuk është zbatuar rekomandimi**, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në korridorin e ambientit të dhomave të shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Librazhd.
3. **Nuk është zbatuar rekomandimi**, për krijimin e një ambienti të përshtatshëm ku intervistohen/merren në pyetje shtetasit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë në këtë institucion, dhe të ndërprerjes të praktikës së marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës.²
4. **Nuk është zbatuar rekomandimi**, për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
5. **Nuk është zbatuar rekomandimi**, për plotësimin e dhomës së shoqërimit, me orënditë e nevojshme, si tavolinat dhe karriget, të cilat shërbejnë për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, të cilat duhet të jenë të fiksuara në dysheme dhe të pa lëvizshme, sikurse përcaktohet në procedurat standarde.
6. **Nuk është zbatuar rekomandimi**, për mirëmbajtjen e dhomave të shoqërimit, lyerjen e tyre dhe garantimin e kushteve higjieno-sanitare në dhomat e shoqërimit dhe të tualeteve në ambientet e Komisarlatin të Policisë Librazhd, si dhe rregullimin e bravave të dyerve për mbylljen e tyre.

Është rasti të theksojmë se lidhur me plotësimin e standardeve të ambienteve të dhomave të shoqërimit dhe respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar në konflikt me ligjin, rekomandimet e Avokatit të Popullit duhen vlerësuar maksimalisht nga institucionet që ato ju drejtohen. Këto rekomandime nuk ju drejtohen personave të caktuar personalisht, por institucioneve të administratës publike dhe drejtuesve të tyre me cilësinë e titullarit. Ne vlerësojmë se nuk është aspak serioze që me ndryshimin e titullarëve të institucioneve (Komisariateve të Policisë) të ndryshojë edhe qëndrimi ndaj rekomandimeve të bëra më parë nga Avokati i Popullit, sikurse ka ndodhur dhe këtë rast për mos zbatimin e rekomandimeve në Komisarlatin e Policisë Librazhd.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues konstatoi se, në ambientet aktuale në Komisarlatin e Policisë së Librazhd, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe konkretisht:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Ambienti i shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Librazhd, nuk ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, ku parashikohet se dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit.³

² Kreu VII, pika 4/d e Procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”.

³ Kreu VI, pika 3 e Procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”.

Mjedisi i shoqërimit ndodhej në një ndërtesë më vete nga godina kryesore e komisariatit. Kjo ndërtesë ishte e ndërtuar në vitin 2019, sipas parashikimeve të bëra në ligjin 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar. Godina e re ishte e përbërë nga dy ambiente, konkretisht nga zyra për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe nga mjedisi që shërben për mbajtjen dhe qëndrimin e personave të shoqëruar në Komisaratin e Policisë Librazhd.

Mjedisi i shoqërimit përbëhej nga **1 (një) dhomë shoqërimi**, e cila përdorej për meshkujt madhorë, ndërkohë **që nuk kishte dhomë për shoqërimin e grave dhe të miturve**.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka përsëritur në mënyrë të vazhdueshme se investimet për ndërtimin e institucioneve të privimit të lirisë dhe konkretisht në Komisaratin e Policisë Librazhd duhet të jenë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në rastin konkret ndërtimi i ambienteve të shoqërimit të këtij institucioni **nuk** ishte sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, ku parashikohet se dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit.

Gjithashtu, theksojmë se investimi për ndërtimin e godinës së dhomave të shoqërimit në këtë komisarati është bërë në vitin 2019 nga një investim i financuar nga programi i Qeverisë Suedeze për Policimin në Komunitet (SCPA), mbi bazën e projektit të miratuar nga strukturat përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Por, nga inspektimi i bërë në këtë komisarati konstatoam se gjendja teknike e godinës kishte filluar të amortizohej për shkak të lagështirës dhe kishte nevojë për ndërhyrje të menjëhershme për rikonstruksionin e saj. Në dhomën e shoqërimit, niveli i lagështirës ishte tej normave të pranueshme, duke patur ndikim negativ në jetën dhe shëndetin e personave të shoqëruar, si dhe për vetë punonjësit e Policisë së Shtetit.

Pavarësisht rekomandimeve të mëparshme të Avokatit të Popullit, në Komisaratin e Policisë Librazhd mbetet si problematikë, mungesa e dhomave të shoqërimit më vete për gratë dhe të mitur. Mungesa e dhomave të shoqërimit për femrat dhe të miturit në konflikt me ligjin është një nga problemet që paraqitet në këtë komisarati, duke mos siguruar garantimin e lirive, të drejtave dhe standardeve që kanë të bëjnë me shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin në mjediset e policisë, si dhe nevojave fizike, profesionale dhe psikologjike, kur merren vendime që prekin ndonjë aspekt të ndalimit të tyre.⁴

Dhomat e shoqërimit ishin me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin ulur të personave, me kushte të përshtatshme dhe të pajisura me orënditë e nevojshme, si 1 (një) tavolinë dhe 2 (dy) karrige të reja, por ato **nuk** ishin të fiksuara në dysheme në mënyrë të palëvizshme, sikurse përcaktohet në procedurat standarde⁵. Përmasat e dhomave të shoqërimit ishin 4x3m dhe kishin kapacitet për mbajtjen dhe qëndrimin ulur për 4 persona në dhomë.

Dritaret e dhomës së shoqërimit ishin të siguruara me skarë hekuri në pjesën e jashtme, me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto

⁴Në pikën 4/b, Kreu VII, Procedurat standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, përcaktohet se: “*Kushtet e mbajtjes dhe siguria për personat e shoqëruar, në mjediset/ambientet të jenë të ndara më vete për persona të rritur, femra dhe të mitur*”.

⁵ Kreu VI, pika 3/g, Procedurat standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”.

mjedise. Dritaret ishin me përmasa të tilla që krijonin mundësinë e ajrimit dhe ndriçimit të plotë natyral. Gjithashtu kishte edhe ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik. Dera ishte prej druri, me mundësi për t'u mbyllur nga jashtë.

Në ambientet e dhomës së shoqërimit në Komisaratin e Policisë Librazhd kishte sistem ngrohje/ftohjeje, me anë të kondicionimit sikurse parashikohet në procedurat standarde.

Mjediset e dhomës së shoqërimit **nuk ishin të mirëmbajtura**, si dhe kishin nevojë për lyerje dhe për tu mbajtur pastër nga ana higjiëno-sanitare. Ngjitur me dhomën e shoqërimit ndodheshin dy tualete, të ndara më vete për femra dhe meshkuj, me ujë të rrjedhshëm 24 orë dhe të pajisura me të gjitha mjetet e domosdoshme për këtë qëllim. Kushtet higjiëno-sanitare janë shumë të rëndësishme në ambientet e privimit të lirisë dhe gjendja e tyre varet nga organizimi i punës dhe për këtë Avokati i Popullit kërkon vëmendje maksimale nga drejtuesit e komisarariatit dhe stafi përgjegjës. Pastërtia e ambienteve është thelbësore pasi tregon qartë kujdesin ndaj qytetarëve dhe është përballushme nga pikpamja e kostove.

Gjithashtu, në anën e majtë të korridorit të dhomave të shoqërimit, ndodhej edhe një ambient tjetër i cili ka shërbyer si dhomë për gratë e shoqëruara në konflikt me ligjin, por aktualisht shërbente si zyrë pune për Specialistin e Policisë së Zonës (SPZ) dhe njëkohësisht shërbente edhe për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar. Ky ambient ishte i pajisur me tavolina, karrige dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, si dhe me orenditë e nevojshme si karrige dhe tavolina pune për specialistët e policisë⁶, por nuk kishte të instaluar kamerat e monitorimit.

Në mjediset e komisarariatit **nuk** ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambienteve të shoqërimit. Mbikëqyrja me kamera e mjedisëve të komisariateve, përveç mjedisëve ku çenohet privatësia, është vlerësuar nga ana jonë si një proces thelbësor për tre arsye:

Së pari, mbikëqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen si nga ana e të shoqëruarve, të ndaluarve apo të arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Së dyti, mbikëqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të komisarariatit, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

Së treti, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të shoqëruarve, të ndaluarve apo të arrestuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet përkatëse që hartojnë institucionet monitoruese të pavarura. Vlen të theksohet se ata shërbejnë për garantuar besimin e qytetarëve të Policia e Shtetit.

Në Komisaratin e Policisë Librazhd, gjatë periudhës 01.01.2023 deri më 17.05.2023 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **49**

⁶ Kreu VI, Pika 3/d, Procedurat standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në polici", miratuar me Urdhrin Nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

persona, ku të gjithë ishin shtetas madhorë, ndërsa shtetas të mitur dhe shtetase femra të shoqëruara në konflikt me ligjin nuk kishte gjatë kësaj periudhe, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 109 dhe 112/1⁷ të ligjit “Për Policinë e Shtetit”. Në momentin e inspektimit **nuk kishte asnjë shtetas** në dhomat e shoqërimit.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës dhe të ambientit të shoqërimit, si dhe në dhomën e shoqërimit të këtij komisariati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Në vijim, na u bë me dije se personat e shoqëruar nga policia janë të informuar për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë⁸. Mekanizmi Kombëtar kërkon dhënien e kopjes së kartës së të drejtave të të dënuarve që në momentin e hyrjes në komisariat, për të garantuar njohuritë e tyre për të drejtat që ata kanë. Kjo garansi nuk jepej personave të shoqëruar në këtë komisariat.

Nga verifikimi i regjistrimit të marrjes dhe dorëzimit të personave të shoqëruar dhe kopjeve të procesverbalit të veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar, në rubrikën me shënimet në lidhje me ankesat/kërkesat e të shoqëruarve rezultoi se, për vitin 2023 nuk kishte asnjë ankesë të regjistruar.

Gjatë inspektimit nuk u konstatua asnjë rast, apo u administrua ankesë lidhur me ushtrim dhune apo trajtim degradues nga punonjësit e policisë. Gjithashtu u këqyrën të gjitha zyrat e oficerëve të Policisë Gjyqësore në të gjitha ambientet e komisariatit. Në zyrat e lartpërmendura nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj shtetasve që intervistohen/merren në pyetje.

Në vijim, gjatë inspektimit u konstatua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Më tej u evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku rezultoi se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë së komisariatit, mbaheshin procesverbalet përkatëse dhe një kopje e firmosur i jepej personit të shoqëruar.

⁷ Paragrafi 1 i nenit 112 parashikon se: “Për të regjistruar nga ana administrative të dhënat e personave të shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar, policia kryen këto veprime: 1. Në rast shoqërimi, policia evidenton për çdo person të shoqëruar të dhënat për: a) gjenealitetet; b) vendbanimin; c) përshkrimin e pamjes së personit, përfshirë shenja të veçanta; ç) punën që kryen; d) arsyet e shoqërimit; dh) orën, datën dhe vendin e shoqërimit; e) zyrën e policisë ku është kryer shoqërimi; ë) punonjësin e policisë, i cili ka kryer shoqërimin.”

⁸ CPT u bën thirrje autoriteteve shqiptare të ndërmarrin hapa për të siguruar që personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë (domethënë, nga momenti kur ata janë të detyruar të qëndrojnë në polici). Kjo duhet të sigurohet me dhënien e informacionit të qartë verbal që në fillim, për t'u plotësuar në rastin më të shpejtë (domethënë, menjëherë pas mbërritjes në ambientet e policisë) me sigurimin e fletës së informacionit të lartpërmendur. Personave në fjalë duhet t'u kërkohet të nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se ata kanë marrë një kopje të fletës së informacionit. Raporti CPT-së për Shqipërinë CPT/Inf (2019) 28 [par.24]. Konsulto: <https://rm.coe.int/168097986b>.

Në kohën e kryerjes së inspektimit, sikurse u raportua edhe më lart nuk kishte asnjë person të shoqëruar në mjediset e komisariatit, për rrjedhojë grupi i inspektimit nuk realizoi intervista lidhur me trajtimin që ju bëhet personave nga ana e punonjësve të policisë nga momenti i shoqërimit, gjatë kohës së qëndrimit në dhomat e shoqërimit, gjatë marrjes në pyetje apo intervistimit të tyre.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisarlatin e Policisë Librazhd nuk kishte ambiente sigurie të miratuara. Personat e arrestuar/ndaluar, pasi përfundonin veprimet procedurale, dërgoheshin nga punonjësit e policisë në dhomat e sigurisë së Komisarlatit të Policisë Elbasan.

Regjistri i personave të shoqëruar dhe trajtimi i të shoqëruarve

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë Librazhd, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i ri sipas tipit “Model nr.1”, konform procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Ky regjistër ishte i sekretuar.

Personat e shoqëruar në mjediset e policisë, sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme, nga 1 orë deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë në zyrën e informacionit⁹.

Në këtë komisarlat kishte regjistër për personat e arrestuar/ndaluar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e momentit të shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisarlat nuk administrohej regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar. Sa më sipër përbën cënim të standardit të parashikuar në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 925, datë 18.07.2019 “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, përkatësisht në Kreun XV “Procedurat për evidentimin dhe trajtimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të ndaluar dhe të arrestuar”, pika 5.1, gërma “c”¹⁰.

Nga inspektimi u konstatua se Komisarlati i Policisë Librazhd, ishte pajisur me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se gjatë vitit 2023 ishte vetëm një i shoqëruar i mitur në konflikt me ligjin.¹¹

⁹ Kreu VII, Procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

¹⁰ Punonjësi i policisë që merr ankesë/kërkesën e pasqyron atë në regjistrin e ankesë/kërkesave sipas rubrikave përkatëse, si dhe nënshkruan për këtë gjë në rubrikën përkatëse të regjistrin.

¹¹ Detyrim i përcaktuar nga ligji nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

Për rrjedhojë u konstatua se ishte plotësuar standardi për pasqyrimin me saktësi dhe përgjegjësi të rubrikave të librit të shoqërimit nga punonjësit e policisë të zyrës së informacionit.

Ambientet e intervistimit

Në Komisarlatin e Policisë Librazhd, oficerët e Policisë Gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre të punës. Këto ambiente nuk ishin të monitoruara me kamera, për vëzhgimin gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e Policisë Gjyqësore.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të veçanta për marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e Policisë Gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por sikurse u përshkrua edhe më sipër, ky rekomandim nuk është zbatuar ende.

Sipas përcaktimit të kreut VII pika 5/ç, të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, parashikohet se, personat e shoqëruar deri në sqarimin e pozitës dhe arsyes së shoqërimit mbahen në ruajtje dhe monitorim të punonjësit të policisë së funksionit të caktuar ose me mjete të tjera digjitale (sisteme të kamerave video-audio) dhe në vijim të kreut XIV, pika 6/b, përcaktohet se: *“Në dhomat e intervistimit/marrjes në pyetje të të arrestuarve/ndaluarve duhet regjistruar në elektronikë procesi i marrjes në pyetje apo veprimet e tjera procedurale hetimore me të arrestuarit/ndaluarit”*.

Në ambientet e Komisarlatit të Policisë Librazhd ishte një zyrë që shërbente si zyrë pune për Specialistin e Policisë së Zonës (SPZ) dhe njëkohësisht shërbente edhe për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar vetëm nga Specialisti i Policisë së Zonës (SPZ) të institucionit.

Komisariati i Policisë Librazhd në kushtet aktuale nuk posedon hapësirë të posaçme për komunikimin apo intervistimin me persona të mitur, ndaj MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët dhe pyetja e tyre duhet të realizohen në një ambient që duhet të jetë i përshtatur në mënyrë të posaçme për zhvillimin e intervistimeve me fëmijët, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohen pasoja të rënda deri në trauma tek të miturit që janë në konflikt me ligjin.

Dokumentimi elektronik i intervistimit të personave të shoqëruar është një masë tepër efikase për parandalimin e dhunës psikologjike.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se, në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre ju sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht.

Punonjësit e policisë i parashtruan grupit të inspektimit, se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut.

Gjithashtu, na u bë me dije se njoftimi për ndihmë juridike nga avokati i siguruar kryesisht për personin e shoqëruar bëhet menjëherë pasi merr miratimin e personit të shoqëruar në konflikt me ligjin. Vonesa e avokatit nga momenti i njoftimit është rreth 1 orë. Gjatë verifikimit të regjistrave të personave të shoqëruar u konstatua se procedura e ndjekur nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Librazhd ishte zhvilluar konform ligjit.

Përsa i përket psikologut na informuan se duke u bazuar në praktika, si: mbështetje psikologjike, diagnostikim, këshillim psikologjik, vlerësim, formim për persona që u privohet liria, ai sigurohet nga Shkolla e Mesme e qytetit Librazhd, por në rastet e të miturve në konflikt me ligjin, psikologu sigurohet menjëherë nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, por edhe nga Bashkia apo Shkolla e Mesme e qytetit. Sipas rastit vonesa në këto raste është gjysmë ore. Mekanizmi Kombëtar kërkon që avokati dhe psikologu të jenë të pranishëm në institucionin e privimit të lirisë, që në në momentin e hyrjes të të shoqëruarve në komisariat, për të garantuar njohuritë e tyre për të drejtat e tyre dhe mbështetje psikologjike në rrethanat në të cilat këta shtetas ndodhen në institucion.

Në rastet kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, ata i shoqërojnë në Qendrën Shëndetësore Librazhd, për të marrë ndihmën mjekësore.

Përsa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”, me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme, për gjetjen e fondeve për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Librazhd, sipas kriterëve të parashikuara në Kreun VII, pika 4 të procedurave standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së shtetit*”, miratuar me Urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për ndërtimin e ambienteve të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrimin në dhomat e shoqërimit të ndara më vete për persona të rritur, femra dhe të mitur në konflikt me ligjin dhe mos ndërtohen komisariate që nuk janë në përputhje me “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”.
2. Marrjen e masave të menjëhershme, për hidroizolimimin e tarracës të godinës së dhomave të shoqërimit të Komisarariatit Librazhd, për eliminimin e lagështirës së dhomave të shoqërimit në këtë institucion.
3. Marrjen e masave të menjëhershme, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në korridorin e ambientit të dhomave të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Librazhd.

4. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e një ambienti të përshtatshëm ku intervistohen/merren në pyetje shtetasit duke përdorur pajisje elektronike, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë në këtë institucion, dhe të ndërpritet praktika e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës.¹²
5. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
6. Marrjen e masave të nevojshme në dhomën e shoqërimit, që orenditë e nevojshme si tavolinat dhe karriget, të cilat shërbejnë për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, të jenë të fiksuara në dyshe dhe të pa lëvizshme, sikurse përcaktohet në procedurat standarde.
7. Marrjen e masave të menjëhershme, për mirëmbajtjen e dhomave të shoqërimit, lyerjen e tyre dhe garantimin e kushteve higjieno-sanitare në dhomat e shoqërimit dhe të tualeteve në ambientet e Komisarariatit të Policisë Librazhd, si dhe rregullimin e bravave të dyerve për mbylljen e tyre.
8. Marrjen e masave administrative për personat që kanë përgjegjësi për organizimin e punës për mirëmbajtjen dhe pastërtinë e tyre.
9. Marrjen e masave të menjëhershme, për pajisjen me një regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, në Komisarariatit të Policisë Librazhd.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONER

AHMET PRENÇI

¹² Kreu VII, pika 4/d Procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.